Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**12.12.2023**	**22.12.2023**	**2023/0998**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.12.2023, OE "PRO MEDICAL SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0998, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE " MADEKOS SH.P.K"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material shpenzues medicional per nevojat e QKMF-se" me nr. të prokurimit: "656-23-11669-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: 80,200.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 24.10.2023, data e hapjes së ofertës: 13.11.2023, data e njoftimit mbi vendimin e AK-se: 23.11.2023, data e njoftimit me letër standarde: 23.11.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura te LPP-se nga ana e Autoritetit Kontraktues konsistojnë ne:

Neni 1 Qëllimi,

Neni 7 Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Neni 61 Tenderer Jo-normalisht te Ulet

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtese.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale** **1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Kopje- Çertifikata e Biznesit**
		2.Çertifikata e TVSH-së,	**2.Kopje- Çertifikata e TVSH**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar** **Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskalë (2020, 2021 dhe 2022) ka qenë prej jo më pak se 160,000.00 Euro.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Kopje të pasqyrave në të a raporteve të menaxhmentit të çert një kompani e licencuar e a reputacion për vitet (2017,2018 d bashkëngjitet kopja e noterizuar Auditimit) ose Deklaratat e d Administratën Tatimore te Kosov**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime te ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 120,000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Lista e kontratave (e nensh vulosur), operatori ekonomik operatoreve ekonomik duhet te kontratave te realizuara gjate fundit nga data e njoftimit per ko tenderi ne origjinal, te nenshkru nga OE, te deshmuar me referen te pranimeve te furnizimeve te vleren, daten.Kur furnizimi esh ndonje kompani private duhet te deshmia nga banka per ato refere**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i papergjegjshem.

OE i rekomanduar per kontrate eshte i pergjegjshem.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PRO MEDICAL SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

OE ankues si i pakënaqur me vendimin B58 te datës: 23.11.2023, ka dorëzuar ankese ne OSHP, me pretendimin se AK-ja, nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat e nenit 59, 61 dhe 72 te LPP-se.

Gjatë shqyrtimit fillestare eksperti shqyrtues ka vërejtur se AK-ja, ka rekomanduar operatorin ekonomik me çmim me te lire, ndërsa OE ankues është i pesti me radhë sipas çmimit te ofruar.

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës së poentuar (€)
1.	MEDPLUS SH.P.K., Rr.Pranvera e Lirisë, 10000, Prishtinë	15.85 €
2.	MADEKOS SH.P.K., Vragoli (Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fushë-Kosovë	12.57 €
3.	NARA BIOTICS SH.P.K., Rr.Mbretresha Teutë, 10000, Prishtinë	39.49 €
4.	PRO MEDICAL SH.P.K., Rr.Kadri Zeka, 70000, Ferizaj	88.07 €
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik Ardi SH.P.K.; INFINITT SH.P.K., 187, Nënë Tereza, Fushë Kosovë, 12000, Fushë Kosovë	64.74 €

Ne ankesën e tij te deponuar ne OSHP, ka pretendim kryesore çmimin e OE te rekomanduar për kontrate për te cilin pretendon se ka dhënë çmime JoNormalisht te ulëta dhe me ketë rast pretendon se nuk janë respektuar dispozitat e nenit 61 te LPP-se dhe 41 te RrPP-se 001/2022.

Autoriteti kontraktues, lidhur me çmimet e ofruara nga i rekomanduari për kontrate, ka kërkuar sqarime me datën: 17.11.2023 dhe ne përgjigje OE i rekomanduar për kontrate ka deklaruar se:

Kompania Made-Kos me seli në Prishtinë deklaron se per oferten tone ne tenderin e larte permendur ju garantojme se kemi ofruar cmime normale dhe produkte te kualitetit sipas standardeve europiane.

Poashtu, edhe ju jeni ne dijeni se ne ka disa vite qe ju kemi furnizuar me keto cmime dhe nuk kemi pasur asnje verejtje per mos realizim te vetem ndonje produkti e lere më, me shume produkte.
Ju garantojme se jemi te gatshem te qendrojme prapa ofertes tone per furnizim sipas kushteve te kontrates dhe jemi te gatshem te ofrojme sigurimin e ekzekutimin me shume se 10% sic eshte e parapare ne dosjen e tenderit.

Autoriteti kontraktues pas pranimit te përgjigjes se cituar me larte, është bindur me arsyetimin e dhënë nga OE i rekomanduar për kontrate dhe ka vepruar ne harmoni me nenin 61.3 te LPP-se.

61.3 Pasmarrjesparasysh tëinformacioneve dhe shpjegimeveqë janë dorëzuarngatenderuesi

sipasparagrafit 1.të këtijneni,nëse autoriteti kontraktues konstaton setenderuesi kadorëzuar njëshpjegimtë mjaftueshëmtë bazavetë tenderittëtij, autoriteti kontraktuesduhettë trajtojë tenderine tillënëmënyrëne njëjtësiç itrajtonedhe tenderëte tjerë.

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas paragrafit 3 te nenit 61 te LPP-se është e drejte e AK-se vlerësimi i çmimeve, prandaj pretendimi i OE ankues nuk qëndron.

Pretendimi 2.

Ne ankesën e tij OE ankues jep argumentet e veta se AK-ja pa te drejte na ka eliminuar sepse eshte dashur te kërkojë sqarime për ISO certifikatën.

Eksperti shqyrtues sqaron se përmes letrës standarde OE ankues është njoftuar nga AK-ja, si tenderues i eliminuar me arsyetimin se:

Ju nuk i keni ofruar në ofertën tuaj ISO certifikatat të cilat janë kërkuar sipas Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne ofertën e tij nuk e ka dorëzuar certifikatën ISO, megjithatë me te drejte pretendon se AK-ja është dashur te kërkojë sqarime sipas nenit 72 te LPP-se.

Vlen te përmendet se OE ankues siç u sqarua edhe me larte është i pesti me radhë sipas çmimit dhe ne ankesën e tij nuk i ka atakuar operatoret tjerë ekonomik te cilët janë te përgjegjshëm sipas raportit te vlerësimit. Ne ketë rast edhe po te kthehej ne rivlerësim ky aktivitet i prokurimit OE ankues nuk mund te jetë nënshkrues i kësaj kontrate sepse me vet faktin qe nuk i ka atakuar OE-te e tjerë është pajtuar me vlerësimin e bere nga AK-Komuna e Ferizajit dhe poashtu fakti qe nuk i ka atakuar OE-te e tjerë e bene OE ankues palë pa interes material sipas nenit 4.1.26 te LPP-se dhe 111 te LPP-se.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA FERIZAJ**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **PRO MEDICAL SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Florije Rexhepi